

A - Lutjes për ndërrimin e vendit të punës tek punëdhënësit të njëjtë (paragrafi i tretë i nenit 20. të Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:

- pasaportën valide ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës valide së të huajit;
- kontratën mbi punësimin, të cilën e nënshkruan punëdhënësi, se paku për një vit, në të cilën të huajit duhet ti jetë e garantuar paga në lartësi së paku prej 1,5 të pagës bruto mesatare vjetore në Republikën e Sllovenisë, e cila përlogaritet në bazë të pagës bruto mesatare mujore në Republikën e Sllovenisë, të shpallur së fundmi në Gazetën zyrtare të Republikës së Sllovenisë;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- dëshminë mbi arsimimin adekuat (së paku arsimimi i lartë i shkallës së dytë);
- dëshmitë, se i huaji i plotëson kushtet, të cilat i kërkon punëdhënësi.

Në procedurën e dhënies së pëlqimit tek miratimi me shkrim për ndërrimin e vendit të punës tek punëdhënësit të njëjtë, Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim do të verifikoi, se në evidencën e personave të papunësuar nuk ka person adekuat të papunësuar.

B - Lutjes për ndërrimin e punëdhënësit (paragrafi i katërtë i nenit 20. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve) duhet bashkëlidhur:

- pasaportën valide ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës valide së të huajit;
- kontratën mbi punësimin, të cilën e nënshkruan punëdhënësi, se paku për një vit, në të cilën të huajit duhet ti jetë e garantuar paga në lartësi së paku prej 1,5 të pagës bruto mesatare vjetore në Republikën e Sllovenisë, e cila përlogaritet në bazë të pagës bruto mesatare mujore në Republikën e Sllovenisë, të shpallur së fundmi në Gazetën zyrtare të Republikës së Sllovenisë;
- dëshminë për sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë, kur i huaji thekson, se në Republikën e Sllovenisë nuk posedon sigurimin e detyrueshëm shëndetësor;
- dëshminë mbi arsimimin adekuat (së paku arsimimi i lartë i shkallës së dytë);
- dëshmitë, se i huaji i plotëson kushtet, të cilat i kërkon punëdhënësi;
- deklaratën e nënshkruar të punëdhënësit nëse garanton strehimin e të huajit ose jo.

Në procedurën e dhënies së pëlqimit tek miratimi me shkrim për ndërrimin e punëdhënësit përkatësisht për punësim tek disa punëdhënës, Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim do ti siguroi të dhënat në vijim:

- se në evidencën e personave të papunësuar nuk ka person adekuat të papunësuar;
- se punëdhënësi është i regjistruar adekuat ose i regjistruar në regjistrin e ekonomisë bujqësore përkatësisht në regjistrin afarist për kryerjen e veprimtarisë, brenda kornizës të së cilës i huaji do ta kryej punën;
- se punëdhënësi nuk është në procedurën e likuidimit ose falimentimit;
- se punëdhënësi zhvillon afarizëm aktiv;
- se punëdhënësi për të hyrat nga marrëdhënia e punës për gjashtë muajt e fundit para muajit të depozitimit të lutjes ose për kohën e afarizmit, nëse ky është më i shkurtë se gjashtë muaj, ka propozuar përlogaritjet e tërheqjes

tatimore për të hyra nga marrëdhënia e punës, nëse ka punësuar punëtorë, si dhe nuk ka të pa paguara detyrime tatimore të skaduara.

Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonte ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: dpo.mnz@gov.si;
- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit.